

Fakte të Shpejta

Gjatësia e përgjithshme e linjave të Sistemit të Transmisionit të Kosovës (KOSTT sh.a) është 1211.67 km

- ▷ 7 linja 400kV – 188.497 km
- ▷ 13 linja 220kV – 231.882 km
- ▷ 48 linja 110kV – 791.3 km



Nënstacione

- ▷ 1 Nënstacion 400/220 kV me kapacitet të transformatorëve 1200 MVA;
- ▷ 2 Nënstacione 400/110 kV me kapacitet të transformatorëve 600 MVA;
- ▷ 3 Nënstacione 220/110 kV me kapacitet të transformatorëve 1350 MVA;
- ▷ 1 Nyje shpërndarëse 220kV;
- ▷ 1 Nënstacion 220/35/10 kV me kapacitet të transformatorëve 80 MVA;
- ▷ 26 Nënstacione 110/(35 ose 10) kV me kapacitet të transformatorëve 1650 MVA

Kapacitetet bartëse të transmisionit : 1500 MW

Linjat interkonektive në Sistemin Transmetues të Kosovës:

- ▷ 1 linjë 400 kV Kosovë-Serbi
- ▷ 1 linjë 400 kV Kosovë-Mali i Zi
- ▷ 1 linjë 400 kV Kosovë-Maqedoni
- ▷ 1 linjë 220 kV Kosovë-Serbi
- ▷ 1 linjë 220 kV Kosovë-Shqipëri
- ▷ 2 linja 110 kV Kosovë-Serbi

Falë pozitës qendrore gjeografike që ka shteti ynë, sistemi i transmisionit me të cilin operon KOSTT, edhe pse i vogël, paraqet një nyje shumë të rëndësishme të transmisionit në Evropën Juglindore.



**Operator Sistemi Transmisioni
dhe Tregu - KOSTT sh.a**
Rr. Iljaz Kodra pn, 10000 Prishtinë
Republika e Kosovës

Tel: +381 (0) 38 501 601 5

Fax: +381 (0) 38 500 201

E-mail: info@kostt.com

Web: www.kostt.com

E shtypur në Tetor 2013

OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU SH.A.
TRANSMISSION, SYSTEM AND MARKET OPERATOR J.S.C.
OPERATOR SISTEMA, PRENOSA I TRZISTA, A.D.



I themeluar me 1 korrik 2006, KOSTT sh.a është kompani publike pronare e aksioneve të së cilës është Republika e Kosovës, përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

KOSTT sh.a funksionon në bazë të dy licencave të lëshuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

Sipas Licencës për Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Licencës për Operatorin e Tregut të Energjisë Elektrike, KOSTT është përgjegjës për:

- Planifikimin, operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Sistemit të Transmisionit të energjisë elektrike në Kosovë
- Operimin efikas, ekonomik dhe të koordinuar të sistemit të transmisionit, përfshirë rrjedhat ndërkuftare
- Balancimin e sistemit
- Sigurimin e qasjes jo-diskriminuese për shfrytëzuesit e sistemit të transmisionit
- Nxitjen e konkurrencës efektive për prodhim dhe furnizim me energji elektrike
- Nxitjen e efikasitetit ekonomik në zbatimin e Rregullave të Tregut si dhe kryen aktivitetet në përputhje me Rregullat e Tregut
- Administrimin e tregut të centralizuar të energjisë elektrike në Kosovë
- Menaxhimin e procesit të barazimit përfundimtarë

KOSTT sh.a menaxhon Sistemin e Transmisionit të Republikës së Kosovës duke operuar me nivele të tensionit të lartë 400 kV, 220 kV, 110 kV dhe tensionit të mesëm 35 kV, 10 (20) kV.


KOSTT është kompania e parë publike në Kosovë e cila është certifikuar me Standardin ISO 9001:2008, që nga viti 2010.



Misioni

Misioni i KOSTT-it është që të sigurojë:

- Shërbime kualitative duke implementuar arritjet tekniko teknologjike në zhvillimin e sistemit të transmisionit;
- Transparencë dhe jodiskriminim për shfrytëzuesit e sistemit të transmisionit në tregun konkurrues të energjisë elektrike;
- Avansim të pozitës së kompanisë në nivel ndërkombëtar përmes aktiviteteve të shtuara në këtë drejtim



Vizioni

Të ofrojë shërbime të sigurta dhe të besueshme për shfrytëzuesit e sistemit të transmisionit, e përgjegjshme në aspektin social dhe mjedisor, e integruar në mekanizmat evropianë të transmisionit të energjisë elektrike, duke qenë njëkohësisht edhe fitimprurëse.



Operimi i Sistemit të Transmisionit

KOSTT është përgjegjës për proceset e planifikimit, analizave, monitorimit dhe kontrollit të rrjedhave të fuqisë në Sistemin e Transmisionit të Kosovës, në mënyrë të sigurt dhe të besueshme, vazhdimisht 24 orë gjatë 365 ditëve të vitit.

Në përputhje me Kodet Teknike në fuqi, KOSTT siguron që në vazhdimësi të realizohet furnizim kualitativ dhe i sigurt i konsumatorëve me energji elektrike nga aspekti i transmisionit. Po ashtu, KOSTT gjatë gjithë kohës siguron punën sinkrone me Operatorët e Sistemeve tjera të Transmisionit (OST), si dhe ofron shërbimet e operimit të sistemit.

Nga Qendra Nacionale Dispeçerike në KOSTT monitorohet dhe kontrollohen rrjedhat e fuqisë në rrjetin transmetues të Kosovës.

Investimet

Planifikimi dhe zhvillimi i infrastrukturës së Sistemit të Transmisionit bëhet në përputhje me Planin Zhvillimor të Transmisionit (2013-2022).

Gjatë periudhës 2006-2013, janë realizuar investime kapitale në vlerë prej afër 150 Mil. €.

Tregu i Energjisë Elektrike në Kosovë

Në bazë të Licencës së lëshuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, tregu i energjisë elektrike në Kosovë operohet dhe administrohet nga KOSTT sh.a.

Në bazë të Dizajnit të Tregut të energjisë elektrike i cili është aprovuar nga ZRrE në mars të viti 2013, në Kosovë do të krijohen kushte për një treg konkurrues dhe të qëndrueshëm të energjisë elektrike. Në këtë kuadër, janë përgatitur edhe Rregullat e Tregut të cilat pritet të aprovojnë nga ZRrE së shpejti.

Pjesëmarrja në tregun e energjisë elektrike

Pala e cila dëshiron të bëjë tregti në Tregun e Energjisë Elektrike të Kosovës duhet të marrë licencën nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë në Kosovë dhe të nënshkruajë Marrëveshjen e Pranimit të Rregullores së Tregut me Operatorin e Tregut (KOSTT). Palë të licencuara nga ZRrE për të operuar në tregun e energjisë elektrike në Kosovë, deri në shtator 2013 janë 17.

Resurset Njerëzore në KOSTT

Në përmbushjen e objektivave dhe performancën e suksesshme të KOSTT rol thelbësor luajnë punonjësit. KOSTT i kushton vëmendje të veçantë mirëqenies së tyre, shëndetit, kushteve të punës si dhe zhvillimit dhe avancimit të tyre profesional. Numri aktual i punonjësve në KOSTT është 369. Sa i përket gjinisë, si pasojë e natyrës së punës, në KOSTT 87 % të punonjësve janë të gjinisë mashkullore derisa 13 % janë të gjinisë femërore.

